U D H Ë Z I M
Nr.2, datë 25.7.2003

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 11.7.2003 TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE "MBI PROCEDURAT E RISHIKIMIT TË LISTAVE PARAPRAKE TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE 2003"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e tij të datës 25.7.2003, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar
Igli Toska	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar

Në mbështetje të nenit 29/1,6, nenit 31/1, nenit 44/2 dhe të nenit 58 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

U D H Ë Z O N:

Në udhëzimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.1, datë 11.7.2003 "Mbi procedurat e rishikimit të listave paraprake të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2003", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën I. (i) fjalia e fundit bëhet: "Procesi i rishikimit të listave paraprake fillon me shpalljen e tyre dhe përfundon tri javë para datës së zgjedhjeve.

2. Në pikën I.(iii) paragrafi i tretë bëhet: "Vendimi merret kur për të votojnë jo më pak se 5 anëtarë me të drejtë vote të KZQV-së".

3. Në pikat III.a, III.b dhe III.c fjalët "zgjedhësi ose një parti politike" zëvendësohen me fjalët "zgjedhësi, një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucione të tjera të interesuara".

4. Pika III.ç bëhet si më poshtë:

"ç. Zgjedhësi ka ndryshuar vendbanimin ose vendqëndrimin e tij dhe dëshiron të regjistrohet në listën e vendbanimit ose vendqëndrimit të ri.

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë: zgjedhësi, një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar.

Kërkesa duhet të jetë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

2. Dokumentet që duhet të paraqiten pranë KZQV-së:

(i) Kur kërkesa paraqitet nga vetë zgjedhësi:

1. Kërkesë me shkrim për t'u shtuar në listën e zgjedhësve të asaj njësie.

2. Një nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:

- certifikatë me fotografi;
- letërnjoftim;
- pasaportë;
- kartë zgjedhësi;
- dhe kur ka një nga këto tre të fundit dhe fotokopjen e saj.

Fotokopja pasi krahasohet me origjinalin firmoset nga të paktën një anëtar i KZQV-së. Kur dokumentet dorëzohen në QRLZ, fotokopja firmoset nga të dy punonjësit e saj.

3. Një dokument pronësie për të provuar vendbanimin e deklaruar. Kur zgjedhësi është me vendbanim në atë njësi, mjafton një certifikatë personale e lëshuar nga zyra e gjendjes civile e kësaj njësie. Kur zgjedhësi është me vendqëndrim në atë njësi, mjafton një vërtetim nga zyra e gjendjes civile e kësaj njësie që është i regjistruar në regjistrimin e shtetasve me vendqëndrim.

(ii) Kur kërkesa paraqitet nga një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar:

1. Kërkesë me shkrim për të shtuar personin/at përkatës në listën e zgjedhësve të asaj njësie;

2. Kërkesë personale e zgjedhësit e noterizuar, ku të jepet adresa e saktë dhe qendra e votimit që pretendon të jetë;

3. Një dokument pronësie për të provuar vendbanimin e deklaruar. Kur zgjedhësi është me

vendbanim në atë njësi, mjafton një certifikatë personale e lëshuar nga zyra e gjendjes civile e kësaj njësie. Kur zgjedhësi është me vendqëndrim në atë njësi, mjafton një vërtetim nga zyra e gjendjes civile e kësaj njësie që është i regjistruar në regjistrin e shtetasve me vendqëndrim.

5. Pika III.d bëhet si më poshtë:

"d. Zgjedhësi nuk i ka të sakta të dhënat vetjake në listën e zgjedhësve.

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë: zgjedhësi, një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar.

Kërkesa duhet të jetë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

2. Dokumentet që duhet të paraqiten pranë KZQV-së:

(i) Kur kërkesa paraqitet nga vetë zgjedhësi:

1. Kërkesë me shkrim për të saktësuar të dhënat vetjake në listën e zgjedhësve të asaj njësie.

2. Një nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:

- certifikatë me fotografi;
- letërnjoftim;
- pasaportë;
- kartë zgjedhësi;
- dhe kur ka një nga këto tre të fundit dhe fotokopjen e saj.

Fotokopja pasi krahasohet me origjinalin, firmoset nga të paktën një anëtar i KZQV-së. Kur dokumentet dorëzohen në QRLZ, fotokopja firmoset nga të dy punonjësit e saj.

(ii) Kur kërkesa paraqitet nga një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar:

1. Kërkesë me shkrim për të saktësuar të dhënat e zgjedhësit/ve në listën e zgjedhësve të asaj njësie.

2. Kërkesë personale e zgjedhësit e shoqëruar me certifikatë personale të tij.

6. Pas pikës III.d shtohen pikat dh) dhe e) me këtë përmbajtje:

dh) Zgjedhësi është regjistruar në qendrën e gabuar të votimit.

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë: zgjedhësi, një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar.

Kërkesa duhet të jetë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

2. Dokumentet që duhet të paraqiten pranë KZQV-së:

(i) Kur kërkesa paraqitet nga vetë zgjedhësi, ai duhet të paraqesë përpara KZQV-së, një nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:

- certifikatë me fotografi;
- letërnjoftim;
- pasaportë;
- kartë zgjedhësi;
- dhe kur ka një nga këto tre të fundit dhe fotokopjen e saj

Fotokopja pasi krahasohet me origjinalin firmoset nga të paktën një anëtar i KZQV-së. Kur dokumentet dorëzohen në QRLZ, fotokopja firmoset nga të dy punonjësit e saj.

(ii) Kur kërkesa paraqitet nga një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar:

- Kërkesë me shkrim ku të jetë/në shënuar zgjedhësi/sit që pretendohet se nuk është/janë në qendrën e duhur të votimit.

- Kërkesë personale e zgjedhësit ku të jepet adresa e saktë dhe qendra e votimit që pretendon të jetë, e shoqëruar me certifikatë personale të tij.

e) Zgjedhësi nuk është në listën paraprake të qendrës së votimit të vendbanimit të tij.

1. Ka të drejtë të bëjë kërkesë: zgjedhësi, një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar.

Kërkesa duhet të jetë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

2. Dokumentet që duhet të paraqiten pranë KZQV-së:

(i) Kur kërkesa paraqitet nga vetë zgjedhësi:

1. kërkesë me shkrim për t'u shtuar në listën e zgjedhësve të asaj njësie.

2. një nga dokumentet e mëposhtme të identifikimit:

- certifikatë me fotografi;
- letërnjoftim;

- pasaportë;
- kartë zgjedhësi;
- dhe kur ka një nga këto tre të fundit dhe fotokopjen e saj.

Fotokopja pasi krahasohet me origjinalin firmoset nga të paktën një anëtar i KZQV-së. Kur dokumentet dorëzohen në QRLZ, fotokopja firmoset nga të dy punonjësit e saj.

3. Një dokument pronësie për të provuar vendbanimin e deklaruar. Kur zgjedhësi është me vendbanim në atë njësi, mjafton një certifikatë personale e lëshuar nga zyra e gjendjes civile e kësaj njësie. Kur zgjedhësi është me vendqëndrim në atë njësi, mjafton një vërtetim nga zyra e gjendjes civile e kësaj njësie që është i regjistruar në regjistrin e shtesave me vendqëndrim.

(ii) Kur kërkesa paraqitet nga një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar:

- kërkesë me shkrim ku të jetë në shënuar zgjedhësi/sit që pretendohet se nuk është/janë në listën paraprake të asaj njësie, megjithëse është/janë me vendbanim aty, duke vënë dhe adresën përkatëse.

3. Shqyrtimi i kërkesës dhe marrja e vendimit.

(i) Në rastet kur kërkesa është bërë nga zgjedhësi dhe KZQV-ja ka provat e mjaftueshme, merr vendim sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin I, pika (iii) të udhëzimit të KQZ-së nr.1, datë 11.7.2003.

(ii) Në rastet kur kërkesa është paraqitur nga një parti politike, subjekt zgjedhor ose institucion i interesuar, KZQV-ja i kërkon zyrës së gjendjes civile së komunës ose bashkisë, jo më vonë se 24 orë nga bërja e kërkesës, t'i deklarojë nëse personi/at/i/e kërkuar është/janë me vendbanim në atë njësi. Zyra e gjendjes civile duhet t'i kthejë përgjigje KZQV-së jo më vonë se 2 ditë nga paraqitja e kërkesës nga KZQV-ja. Nëse personi nuk është me vendbanim, KZQV-ja rrëzon kërkesën. Nëse personi është me vendbanim, KZQV-ja cakton me vendim, jo më vonë se 24 orë nga marrja e përgjigjes nga zyra e gjendjes civile, një ose sipas rastit disa grupe verifikimi. Grupi i verifikimit përbëhet nga dy persona të propozuar përkatësisht nga kryetari e zëvendëskryetari i KZQV-së.

1. Në rast se grupi i verifikimit gjen zgjedhësin, ai duhet t'i marrë atij një deklaratë nëse dëshiron të votojë në atë njësi zgjedhore. Deklarata është sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja dhe kundërfirmohet dhe nga anëtarët e grupit të verifikimit.

- Nëse zgjedhësi deklaron se nuk dëshiron të votojë në këtë njësi, KZQV-ja përkatëse merr vendim për rrëzimin e kërkesës.

- Nëse zgjedhësi deklaron se dëshiron të votojë në këtë njësi, KZQV-ja i kërkon atij të paraqesë dokumentet sipas pikës e)2(i) dhe merr vendim sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin I, pika (iii) të udhëzimit të KQZ-së nr.1, datë 11.7.2003.

2. Në rastin kur grupi i verifikimit, brenda 4 ditësh nga paraqitja e kërkesës, nuk e gjen zgjedhësin në adresën e dhënë, merr vendim sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin I, pika (iii) të udhëzimit të KQZ-së nr.1, datë 11.7.2003, e shpall atë duke njoftuar njëkohësisht dhe kërkuesin.".

7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.